



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 116

Prishtinë, më 11.7.2024, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi dhe Hydajet Hyseni- Kaloshi.

**Munguan:** Driton Selmanaj, Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa dhe Besnik Tahiri.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raport plotësues për Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime me 6 vota për.*

**2. Raport plotësues për Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin**

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim raportin plotësues për Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin, duke vepruar në pajtim me nenin 78, paragrafi 2 me qëllim të evitimit të kolizionit të referencave në dispozitat e Projektligjit për falimentimin, si dhe evitimin e kolizionit në nenin 92, paragrafi 2 të këtij projektligji.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni, me 6 vota për vendosi që Kuvendit t'ia paraqet për miratim raportin plotësues me 2 amendamente :*

**Raport plotësues  
për Projektligjin nr. 08/L-256 për Falimentimin**

**Amendamenti 1**

1. Në nenin 17, paragrafi 8, referenca “sipas nenit paraprak”, ndryshohet “sipas nenit 16 të këtij ligji”.
2. Në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 referenca “në përputhje me nënparagrafin paraprak.”, ndryshohet “në përputhje me nënparagrafin 1.2, të këtij neni”.
3. Në nenin 30, paragrafi 1, referenca “ sipas nenit paraprak”, ndryshohet “sipas nenit 29 të këtij ligji”.
4. Në nenin 46, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2.2. referenca “sipas nënparagrafit paraprak”, ndryshohet “sipas nënparagrafit 3.2.1, të këtij paragrafi”.
5. Në nenin 64, paragrafi 1, referenca “sipas Kapitullit VI të këtij ligji.”, ndryshohet “sipas këtij kapitulli”.
6. Në nenin 74 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, referenca “sipas atij Kapitulli”, ndryshohet në “sipas kapitullit IV”.
8. Në nenin 104, paragrafi 1, referenca: “në Kapitullin VIII të këtij ligji”, ndryshohet “në këtë kapitull”.
9. Në nenin 112, paragrafi 2, referenca: “Kapitulli IX i këtij ligji”, ndryshohet “Ky kapitull”.
10. Në nenin 123, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, referenca “të parapara në nën paragrafët 2.2 dhe 2.3 të këtij neni,” ndryshohet “të parapara në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të këtij neni”.

**Amendamenti 2**

Në nenin 92, paragrafi 1, në fund të fjalisë së parë, fjalët “shuarjen e shoqërisë aksionare”, ndryshohen më fjalët “shuarjen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar”.

**3. Të ndryshme**

Nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----